



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA PATOS
SEKTORI I PROKURIMEVE PUBLIKE

Nr. ____ Prot .

Patos, më 30/10/2024

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është përfshirë publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: "Blerje asfaltobeton për shtrim rrugësh me afat 3 vjeçar përvitet 2024, 2025, 2026"

Asflat, çakëll dhe rërë bitumi 14213000-7

VLERA E FONDIT LIMIT: 75,268,316 (shtatëdhjetë e pesë milion e dyqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e treqind e gjashtëmbëdhjetë) lekë pa TVSH, vënë në dispozicion nga **Të Ardhura Lokale 2024-2026.**

765,622.17 (shtatëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë gjashiqind e njëzet e dy pikë shtatëmbëdhjetë) euro pa TVSH.

Referuar kursit të këmbimit të Bankës së Shqipërisë më 30.10.2024 ku 1 euro këmbehet me 98.31 lekë.

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

- 2.2.1 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2021, 2022, 2023), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit, me vlerë jo më pak se 75,268,316 (shtatëdhjetë e pesë milion e dyqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e treqind e gjashtëmbëdhjetë) lekë pa TVSH.

Kriteri konsiderohet i përbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros së kërkuar, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP i ndryshuar, si dhe nenin 43 pika 2a dhe pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Shënim: *Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.*

Përcaktimi i viteve të kërkuar për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike". Në percaktimin e vlerës së xhiros autoriteti kontraktor është referuar në pikën 2, gërrma (c) të Nenit 43, Seksioni III të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

- 2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2021,2022,2023 të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktiveve ligjit nr.10091 datë 5.3.2009 ”*Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistiktit te miratuar*” i ndryshuar., ku bilancet e dy vitetëve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivit dhe pasivit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuar për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr.10091 date 5.3.2009 ”*Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistiktit te miratuar*” i ndryshuar.

2.2.3 Vërtetim lëshuar per shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2024, kudo ku operatori ushtron aktivitet, sipas regjistrimit në QKB, ne perputhje me percaktimet e ligjit nr. Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, lidhur me afatet e kryerjes se pagesave të caktuara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore për vitin 2024.

(*Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anetar i grupit duhet të dorëzoj vërtetimin lëshuar nga Bashkia në të cilën është rregjistruar sipas QKB-se).*

Shënim: Kjo kërkesë përbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST dhe dokumentacioni i kërkuar do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përparrë publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe ne ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, ne ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar, nisi 4, pika 2 d).

Referuar sa më sipër, njësia e prokurimit gjykon se kriteri i vendosur nga autoriteti kontraktor lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të vertetimit te shlyerjes se detyrimeve vendore per vitin 2024 sipas kësteve prane bashkise/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qëndrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen eaktivitetit të tyre dhe për tju nënshtuar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi përfurnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit **nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës**, në vlerën **jo më pak se 40% e vlerës së fondit limit të kësaj procedure 30,107,326,4 ALL PA TVSH** (që është një vlerë jo më e madhe se 40% e vlerës së parashikuar të kontratës që prokurohet) Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik përfurmashjen me sukses të kontratës, ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.
- Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë ne vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesi për mallin objekt prokurimi raportin e testimit ose/dhe raportin e analizave ose/dhe skedë teknike, ku të pasqyrohen të gjitha karakteristikat e produktit, me qëllim që autoriteti kontraktor të verifikoj përbushjen e specifikimeve teknike. (Për materialet që do të përdoren si emulsion bitumi, stabilizant, çakell, binder dhe asfaltobeton).

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe pika 6/c të nenit 40, të vkm nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomik të faktojnë specifikimet teknike dhe AK të verifikoj pajtueshmërinë e këtyre specifikimeve me ato të kérkuara në DST.

2.3.3. Fabrikë asfaltbetoni e shoqëruar me leje mijedisore aktive III.1.B

Operatori ekonomik duhet të ketë në pronësi/ose me qera/ose me kontraktë furnzimi fabrikë për prodhimin e asfaltit **e shoqëruar me leje mijedisore aktive III.1.B** copë 1.

Në rastin kur fabrika e prodhimit të asfaltit është më larg se 20 km nga territori i Bashkisë Patos operatori ekonomik duhet të disponoj 4 kamion termik ≥ 20 (njëzet) ton kapacitet mbajtës për transportimin e asfaltit me qëllim që të ruhen vetitë fizike të asfaltit të pështatëshme për shtrim.

Nëse fabrika e prodhimit të asfaltit është më afër se 20 km nga territori i Bashkisë Patos operatori ekonomik duhet të disponoj 4 kamion normal vetëshkarkues për transportin e asfaltit me kapacitet mbajtës ≥ 20 (njëzet) ton.

Edhe në rastin kur fabrika e prodhimit të asfaltit që disponon operatori ekonomik në pronësi/ ose me qera/ ose me kontraktë furnzimi është me afër se 20km dhe operatori ekonomik disponon vetëm kamion termik oferta ekonomike do të jetë e vlefshme. Përsa i përket mjeteve janë të shpjeguara në detaje më poshtë në kriterin 2.3.4.

Pra në rastin e vendodhjes së fabrikës përtej distancës 20 km krahas dokumentacionit të fabrikës së asfaltobetonit operatori do paraqesë vetdeklarimin se disponon mijetet e kërkuarë më sipër.

Fabrika mund të jetë në pronësi, me qira, me kontratë furnizimi. Në rastin kur fabrika e asfaltobetonit është me kontratë furnizimi, operatori ekonomik duhet të paraqesi një vetdeklarim që furnizuesi i mallit të ofertuar disponon lejen si më lartë, duke rezervuar të drejtën e verifikimit të vetdeklarimit si dhe në rastin kur OE del fitues duhet të paraqesi leien e mësimpërme.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pika 6/c të nenit 40, të vkm nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomik të mundësojnë furnizimin e materialit sipas specifikimeve teknike të kërkuara duke ruajtur parametrat e tyre.

Ky kriter është i nevojshëm për ruajtjen e temperaturës së asfaltit nga vendi ipregatitjes deri ne objektet përkatëse.

Për vetë natyrën e punes në objektin asfaltim rrugë del e domosdosme qe gjate kryerjes se punimeve te perdoren lloji dhe sasi materialesh qe jane ne preventive. Nevojat per arsyet te ndryshme do te jene here per sasi te medha dhe here per sasisara me te vogla pasi varet nga siperfaqet qe shtrojme,llojin e nen shtresave kohen dhe motin kur shtrohen etj.

Nevojat per binder apo asfalt mund te jene ne sasira qe te imponojne kriterin e distances 20 km pasi ruhen me mire parametrat normal te ketyre materiale .kryesisht temperature.

-Nga ana e bashkise Patos nuk ka kapacitete dhe nuk disponohen te gjitha mjetet e mjaftueshme per te pergatitur rrugen para shtreses se asfaltit apo binderit.(cakell,stabilizant,tampon rulim etj) per siperfaqe te medha. Zbatimin e ketyre punimeve ne e kryejme pjese pjese sipas mundesive reale dhe kapacitetit te mekanizmave qe duhen ne objekt

Duke hasur veshtiresi ne pergatitjen e siperfaqeve te ndryshme per shtrim mendojme qe distance sa me e afert e fabrikes se asfaltobetonit do ta na ndihmonte per te shtruar me shpejte dhe me mire siperfaqet e planifikuara.

-Ne disa raste mund te dale nevoje emergjente per materialet e preventivuara (sic eshte rasti i shembjes se rrugeve apo gropë të paparashikuara gjatë procesit të parapregatitjes së sipërfaqes për shtrim apo gjatë skarifikimit të rrugëve dhe distance me e afert do te na ndihmonte ne zgjidhjen e problemeve me shpejt dhe me me cilesi.N e keto kushte mendojme qe furnizimi me materialet e percaktuara ne preventiv ne largesine 20 km do te ishte me efikase per autoritetin kontraktor.

Gjithashtu AK bashkia Patos në rastin kur fabrika e prodhimit të asfaltit është më larg se 20 km nga territori i Bashkisë Patos operatori ekonomik duhet të disponoj 4 kamion termik ≥ 20 (njëzet) ton kapacitet mbajtës për transportimin e asfaltit me qëllim që të ruhen vetitë fizike të asfaltit të pështatëshme për shtrim me qëllim mundësimin e të gjithë operatorëve ekonomik të interesuar për të ofertuar.

2.3.4. Kamiona vetshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 20 ton

copë 4

Nr.	Emërtimi	Njësia	Sasia	Shënime
1	Kamion vetshkarkues me kapacitet mbajtës ≥ 20 ton në rastin ku fabrika e asfaltit është më afér se 20 km nga territori i Bashkisë Patos. Në rastin kur fabrika e asfaltit është me larg	copë	4	

<p>se 20 km nga territori i Bashkisë Patos operatori ekonomik duhet të disponoj 4 kamion vetshkarkues termik me kapacitet mbajtës “hotbox” ≥ 20 tonë.</p> <p>Në rastin kur fabrika e prodhimit të asfaltit është më pak se 20 km dhe operatori ekonomik disponon 4 kamion vetshkarkues termik me kapacitet mbajtës “hotbox” ≥ 20 ton oferta e operatorit ekonomik do të kualifikohet e suksesshme.</p>			
----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	--	--	--

Për përbushjen e këtij krietri opératori ekonomik duhet të paraqesi për mjetet në pronësi:

- a. Leje qarkullimi
- b. Çertifikatë pronësie (për mjetet me leje qarkullimi të vjetër)
- c. Policë sigurimi – aktive
- d. Kontolli Teknik me cilësinë “Kalon” (Kolaudimi) – aktive
- e. Çertifikatë transporti
- f. Fotografi për çdo mjet të deklaruar.

Për mjetet e marra me qira operatori ekonomik duhet të paraqesi:

- a. Kontratë qiraje (Kontrata midis palëve duhet të bëhet përpara noterit me afat vlefshmërie brenda afatit për këtë objekt prokurimi).
- b. Leje qarkullimi
- c. Policë sigurimi – aktive
- d. Kontolli Teknik me cilësinë “Kalon” (Kolaudimi) – aktive
- e. Çertifikatë transporti (në emër të qiradhënënsit ose të shoqërisë)
- f. Fotografi për çdo mjet të deklaruar.

Shënim: Kjo kërkesë përbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST dhe dokumentacioni i kërkuar do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njofimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe pika 5/ç të nenit 40, të vkm nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri kërcohët që operatorët ekonomik të mundësojnë furnizimin e materialit sipas specifikimeve teknike të kërkuar duke ruajtur parametrat e tyre.

Duke qene se objektet, rruget ku do të dorëzohen mallrat objekt prokurimi kane një gjatesi te konsiderueshme, si dhe janë një numer i madh rrugësh dhe duke qënë se vazhdimësia e punes do jete përgjatë gjithë ditës bazuar në forcat punetore dhe mjetet që ka në dispozicion Agjencia e Shërbimeve Publike Patos janë të domosdoshëm mjetet e përcaktuara në kritere me qëllim që të përbushin realizimin e kontratës.

Sikundër është sqaruar më sipër në rastin kur fabrika e prodhimit të asfaltit është më larg se 20 km nga territori i Bashkisë Patos operatori ekonomik duhet të disponoj 4 kamion termik ≥ 20 (njëzet) ton kapacitet mbajtës për transportimin e asfaltit me qëllim që të ruhen vetitë fizike të asfaltit të pështatëshme për shtrim me qëllim mundësimin e të gjithë operatorëve ekonomik të interesuar për të ofertuar.

Gjithashtu duke marrë në konsideratë volumin e sasive të kërkuarë kërkohen mjetet si më sipër.

2.3.5. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë si më poshtë:

a) Shofer, kategoria C

4 (katër)

Për plotësimin e këtij kriteri operatori ekonomik duhet të paraqesi:

- kontratën individuale të punës të vlefshme;
- leje drejtimi;
- Të figurojnë në listepagesat e shoqërisë minimumi për 3 muajt e fundit.

(*Në rastin kur punonjësit shofer janë të kontraktuar me kontratë pune (respektivisht për mjetet e marra me qera), nuk kërkohet të figurojnë në listepagesat e shoqërisë.*)

Në raste kur makinerit dispononohen me qera, këta punonjes mund të jenë të kontraktuar nuk kërkohet të figurojnë në listepagesat e shoqërisë, si pasojë nuk mund të jenë domosdoshmërisht në listepagesën e shoqërisë.

Shënim: Kjo kërkesë përbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST dhe dokumentacioni i kërkuar do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njofimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pika 5/b dhe c të nenit 40, të vkm nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Shofere janë përsonat përgjegjës për drejtimin e makinerive në kantier, objekt si dhe jashtë kantierit përfurnizimin dhe transportin e materialeve të nevojshme për objektin që prokurohet. Në raste kur makinerit dispononohen me qera, keta punonjes do të jenë të kontraktuar.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomik të mundësojnë furnizimin e materialit sipas destinacioneve të kërkuarë duke patur në dispozicion fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm përfekzekutimin e objektit të prokurimit.

Sasitë e kërkuarë janë si më poshtë:

Nr.	An	Emertimi i materialeve	Njesia	Sasia
1	3.212	Cakell t=15cm	m3	8,469
2	3.212/b	Stabilizant t=10cm	m3	6,145

3	3.969/2	Emulsion bituminoz 0.5 l/m2	lit	24,979
4	3.222/1	Binder t=5cm	ton	5,495
5	3.226/1	Asfaltobeton t=3cm	ton	372

Për të transportuar volumet dhe sasistë e mësipërme nevojiten minimalisht 4 mjetet e transportit të kërkuareshoqëruar me drejtuesit e tyre sikundër eshtë kërkuar me qëllim që ti përgjigjen furnizimit dhe procesit të punës që do të kryhet nga ak përfituese Agjencia e Shërbimeve Publike Patos janë të domosdoshëm. Theksojmë se punimet kryhet nga Agjencia e Shërbimeve Publike Patos krahas objekteve të tjera që ajo ka për zbatim dhe do të ishte bllokimi i procesit tërësor të së këij autoriteti, pra do të sillte jo vetëm mosrealizim të kontratës por dhe mosrealizim të procesit të punës që ka vetë ASHP Patos.

Pra sikundër argumentuam më sipër numri i makinerive konkretisht kamioneve (ne pronesi apo qira) janë vlerësuar si të nevojshme në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke ju referuar punimeve sipas standardeve, orëve të punës, grafikut dhe kohëzgjatjes së punimeve, si dhespecifikimeve teknike. Për të zbatuar kontratën, operatorët ekonomik duhet të përmbushin kapacitetet teknike të pajisjeve dhe aseteve të tjera fizike, për këtë janë përcaktuar edhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët. Nëpërmjet kapaciteteve teknike operatorët ekonomikë vërtetojnë se zoterojnë aftësinë dhe kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative. Pajisje dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës si dëshmi për mjetet dhe pajisjet sipas specifikave.

2.3.6. Certifikat ISO:

- a) Certifikatën e menaxhimit të cilësisë ISO 9001:2015 (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Certifikatën ISO 9001:2015)

Argumentimi: Kjo certifikatë mundëson që shoqëria të punojë me standarte e cilësi , e cila mundeson implikimi në menaxhim, identifikimi i riskut dhe mundësive, sigurimi i konkurencës për personelin e shoqërisë, mirëmbajtja e pajisjeve dhe infrastrukturës, matja e kënaqësive të klientëve, përgjigje ndaj ankesave të marra dhe vlerësimi i furnitorëve, marrëdhënie biznesi me partnerët e njohur apo një imazh më të mirë në sytë e klientëve.

- b) Certifikatën e menaxhimit të mjedisit ISO 14001-2015 (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Certifikatën ISO 14001-2015.

Argumentimi: Kjo certifikatë mundëson që shoqëria e cila punon/ushton aktivitetin në një zonë prodhimi; e cila përfshin larminë e ajrit, tokës, ujit dhe burimeve natyrore, bimëve dhe kafshëve, dhe qeniet njerëzore dhe shoqërimin e tyre me njëri-tjetrin. Iso 14001 është standardi universal i procesit të monitorimit të përpjekjeve të një organizate drejt mjedisit të saj dhe në një kuptim tjetër të hapave përpara. Eshtë një ndërveprim sistematik që lejon të zbatohet duke i kushtuar vëmendje efekteve rrëth tij gjatë periudhës nga faza e parë e prodhimit deri te dorëzimi

tek perdoruesit e ketij objekti, marrëdhënie biznesi me partnerët e njohur apo një imazh më të mirë në sytë e klientëve.

- c) Çertifikatën e menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit ISO 45001-2018, (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO 45001-2018.

Argumentimi: Standarti ISO 45001-2018 eshte standarde ndërkombëtare, të cilët parashtronë kërkesat për menaxhimin e praktikave të mira të sigurisë dhe shëndetit në punë për çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia. Të dy ofrojnë udhëzime që ju ndihmojnë të hartoni dhe ngrini strukturën e kompanisë suaj mbi sigurinë dhe shëndetin në punë – duke ju dhënë mundësinë të sillni të gjithë kontrollin e duhur dhe proceset në një sistem menaxhimi. Përfitimet Standarti ISO 45001-2018 Menaxhimi i Sigurisë dhe Shëndetit në Punë Jane krijimi i kushtet më të mira të punës në gjitha ndërmarrjet dhe shoqerite, identifikojne kërcënimet dhe vendosin kontrollin për menaxhimin e tyre, reduktojne aksidentet dhe sëmundjet në vendin e punës duke minimizuar kostot dhe kohën joproektive te puntoreve, përfshijne dhe motivojne stafin me kushte më të mira dhe më të sigurta pune, dëshmojne përputhshmëri ndaj klientëve dhe furnitorëve te tyre.

Sistemi i manaxhimit te sigurise dhe shëndetit ne vendet e punës mundeson qe çdo kompani duhet të mbrojë shëndetin dhe sigurinë në punë për të gjithë punonjësit, e cila përfshin vlerësimin e rreziqeve të aksidenteve në punë, vendosjen e masave në fushën e shëndetit dhe sigurisë, inkurajimin e pjesëmarrjes së punonjësve në përpjekjet për të përmirësuar kushtet e punës, zbatimin e masave për të zgjedhur rreziqet e aksidenteve dhe sëmundjeve si dhe hetimin e incidenteve.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, ” (i ndryshuar), nenin 44, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), si dhe ne Kodin te punës, ligji nr. 7961, datë 12.07.1995, i ndryshuar, Ligjin nr.10237 date 18.02.2010 "Per sigurine dhe shëndetin ne pune", VKM nr. 562, datë 03.07.2013 “Për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit në përdorimin e pajisjeve të punës në vendin e punës”, VKM nr. 563, datë 03.07.2013 “Për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit për përdorimin e pajisjeve mbrojtëse individuale në vendin e punës”, VKM nr.312, datë 5.5.2010 "Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier si dhe ne mbeshtetje te natyres se objektit te prokurimit.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

5.1 SHTRESA BAZE ME MATERIAL GURE TE THYER

(stabilizant)

5.1.1 Qëllimi dhe definicioni

Ky seksion përmban përgatitjen e vendosjen e cakëllit të minave, cakëllit të thyer dhe atij makadam në pjesën e themelit. Shtresa "Stabilizant", me fraksione deri 15mm dhe shtresa deri 70 mm.

Stabilizant janë materialet të prodhuar me makineri me fraksione të kufizuara 0 deri në 15 mm.

5.1.2 Materialet

Agregatet (inertet) e përdorura për shtresën bazë të përbërë prej gurëve të thyer do të merren nga burimet e caktuara ne lumenj ose gurore. Kjo shtresë nuk do te përbajë material copëzues (prishës) si psh. pjesë shkëmbinjsh të dekompozuar ose material argjilor.

Agregati i thyer duhet të plotesojë kërkesat e mëposhtme:

- (a) Vleren e copëzimit të aggregateve
- (b) Indeksi i plasticitetit (Indeksi 1 Plasticitetit (PI) nuk duhet të tejkalojë 6.)
- (c) Kërkesat për ndarjen (shkallëzimin)

Shkallëzimi do te behet sipas kufijve te dhena ne tabelen - 1

Shkallëzimi për shtresë themeli të përberë prej gurësh të thërmuar.

Tabela 1

Përmasat e sitës (mm)	Përqindja që kalon (sipas masës)
15	100
10	84-94
6	72-94
4	51-67
5	36-53
1.18	18-33
0.3	11.21
0.075	8-12

Provat për të përcaktuar nëse materiali prej gurësh të thërrmuar i plotëson kërkesat e specifikuara të shkallëzimit do te bëhen para dhe pas përzierjes dhe shpërndarjes së materialit.

SHTRESA ASFALTOBETONI

5.2.1 Klasifikimi i asfaltobetonit.

1. Asfaltobetoni për ndërtimin e shtresave rrugore përgatitet nga përzierja në të nxeh të e materialeve mbushës (cakëll, granit, rërë e pluhur mineral) me lëndë lidhëse bitum.
2. Sipas kërkesës, madhësisë ose imtesise të kokrrizave të materialit mbushës, që përdoret për prodhimin e asfaltobetonit, ai do të kërkohet :

- Asfaltobeton i imët me madhësi kokrrizë deri 15mm.
3. Në varësi nga poroziteti që përmban masa e asfaltobetonit në gjendje të ngjeshur kërkohet:
- Asfaltobetoni poroz (binder) që përgatitet me 60 deri 75% çakëll të thyer, 20 deri në 35% rërë dhe që mbas ngjeshjes ka porozitet mbetës 5 deri 10% në vëllim.
4. Astalto betoni poroz për shtresen lidhëse (binder)
5. Asfalto betoni i ngjeshur në varësi nga përbajtja e pluhurit mineral e shprehur në përqindje në peshë dhe të cilësive të materialeve përbërës të tij, do të kërkohet:
- Kategoria I me përbajtje 15% pluhur mineral

5.2.2 Përcaktimi i përbërjes së asfaltobetonit

- a) Kategoria, lloji, trashësia e shtresës dhe kërkuesat teknike të asfaltobetonit, përbërja për prodhimin e asfaltobetonit, që shpreh raportin midis elementeve përbërës të tij (çakëll ose zall i thyer, granil, rërë, pluhur mineral e bitum) si dhe treguesit teknikë të masës së asfaltobetonit në gjendje të ngjeshur, përcaktohen me prova laboratorike.
- b) Në tabelen 2 janë paraqitur kërkuesat e STASH 660-87 mbi përbërjen granulometrike të mbushesave dhe përqindjen e bitumit për prodhimin e lojeve të ndryshme të asfaltobetonit, mbi tëcilat duhet të mbeshtet punë eksperimentale laboratorike për përcaktimin e përbërjes (recetave) të asfaltobetonit për prodhim.

Tabela 2, Përbërja granulometrike dhe përqindja e bitumit në lloje të ndryshme asfaltobetoni.

Nr	Lloji i Asfaltobetonit	Mbetja në % e materialit mbushës ne mm													Kalon në 0.0 7	Bitum it në %
		40	25	20	15	10	5	3	1.2 5	0.6 3	0.3 15	0.1 4	0.0 71			
I	Asfaltobeton granulometri të vazhduar															
1	Kokërr mesatar	-	-	0-5	8-14	7-11	13 - 20	9-10	14-13	11-8	10-5	7-5	8-3	13-6	5-5.6	
2	Kokërr imët	-	-	-	0-5	11-18	17 - 25	7-12	6-13	11-8	8-4	9-6	6-1	15-8	6-8	

Përbërja e afaltobetonit e përcaktuar në rugë eksperimentale në laboratori jepet për prodhim vetëm atëhere, kur plotësohen kërkuesat teknike sipas projektit të zbatimit dhe të STASH 660-87 të pasqyruar në tabelën 3.

Tabela 3 Kërkesat teknike qq duhet të plotësojë asfaltobetoni sipas STASH 660-87

Nr	Treguesi teknike	Asfaltobeton I ngjeshur
		Kategoria e I
1	Rezistenca në shtypje në temp. 20 °C C/cm' jo më pak se	25
2	Rezistenca në shtypje në temp. 50 °C C/cm' jo më pak se	10
3	Qëndrueshmëria ndaj të nxehtit Knx= R-20/R50	2.5
4	Qëndrueshmëria ndaj ujit K-ujë jo më pak se	0.9
5	Poroziteti përfundimtar (mbas ngjeshjes) në% në vellim	3.5
6	Ujëthithja % nëvellim jo më shumë se	1-3
7	Mufatja % në vellim jo më shumë se	0.5

5.2.3 Kërkesat teknike ndaj materialeve përbërës të asfaltobetonit.

- a) Bitumi që përdoret për prodhimin e asfaltobetonit si dhe në asfaltimet e tjera me depërtim ose trajtim sipërfaqësor, duhet të plotësoje kërkesat e Stash 660-87 ose të STASH CNR Nr. 1996 "Karakteristika për pranim"
- b) Çakëlli, zalli, zalli i thyer dhe granili duhet të plotësojne kërkesat e STASH 539-87 "Përpunime ndërtimi".
- c) Rezistenca në shtypje e shkëmbinjeve nga të cilët prodhohet me copëtim mekanik çakëlli e granili, duhet të jetë jo më pak se 800kg/cm², këshillohet që për shtresën përdoruese, rezistenca në shtypje e shkëmbinjëve të jetë mbi 1000kg/cm²
- d) Zalli i thyer duhet të përmbarjë jo më pak se 35% kokrriza të thyera me madhësi mbi 5mm. Sasia e kokrrizave të dobëta (me rezistencë më pak se 800 kg/cm?) nuk duhet të jetë me shumë se 10% në peshë, për kategorinë e parë të asfaltimit dhe jo më shumë se 15% në peshë për kategorinë e dytë të asfaltimit. Sasia e kokrrizave në formë pete dhe gillpëre, të mos jetë më shumë se 25% në peshë për shtresën lidhëse (binder)
- e) Rera për prodhim asfaltobetoni mund të përfitohet nga copëtimi dhe bluarja e shkëmbinjve me rezistencë në shtypje mbi 800 kg/cm² ose nga lumi dhe në cdo rast, duhet të plotësojë kërkesat e STASH 506-87 "Rëra për punime ndërtimi"
- f) Pluhuri mineral që perdoret për prodhim asfaltobetoni, mund të përfitohet nga bluarja e shkëmbinjëve gëlqerore ose pluhur TCC, çimento, etj. Në çdo rast pluhuri mineral duhet të plotësojë kërkesat lidhur me imtësinë dhe hidrofilitetin.

- g) Imtesia e pluhurit mineral duhet të jetë e tillë, që të kalojë 100% në sitën me madhësi te vrimave 1.25 mm dhe të kalojë jo më pak se 70% në peshë në sitën 0.074 mm.
- h) Koeficienti i hidrofilitetit të pluhurit mineral, i cili shpreh aftësinë lidhëse me bitumin të jetë jo më shumë se 1.1

5.2.4 Prodhimi dhe transporti i asfaltobetonit

a) Asfaltobetoni prëgatitet në fabrika të posaçme, të cilat këshillohet të ngrihen sa më afër depozitave të lëndëve të para dhe vendit të përdorimit të tij (jo më larg se 20 km nga blloku i rrugëve që do të shtrohen), në menyrë që ti përgjigjen kërkesës që do të lind për lëndë të parë (stabilizant ose asfalt) nga stafi /operatori që do të marr përsipër transportin dhe shtrimin e shtresave rrugore të parashikuara. Gjithashtu kjo gjë do të mundësoj ruajtjen e parametrave fiziologjike (temperaturë, shkriftim) të asfaltit. Aftësia prodhuese e fabrikës përcaktohet në varësi nga plani i organizimit të punës, që zbaton punimet e ndërtimi të rrugës, për një afat 60 ditor

b) Materialet mbushës të asfaltobetonit sic janë çakëlli, zalli, granili e rëra duhet të depozitohen pranë fabrikës në bokse të vecanta. Para futjes së tyre në përzierës ato duhet të thahen dhe nxehen dëri në tëmperaturën 250°C, pastaj dozohen dhe futen ne përzierës.

c) Pluhuri mineral duhet të ruhet në depo të mbuluara dhe pa lagështi. Në çastin e dizimit dhe futjes në përzierës, ai duhet të jetë i shkrifte (i patopëzuar) dhe i thatë. Kur përmban lagështi duhet të thahet paraprakisht dhe futet në gjendje të nxehëtë në perzierës.

d) Bitumi, në prodhimin e asfaltobetonit futet në gjendje të nxehëtë, por temperatura e tij nuk duhet të jetë mbi 1700°C për ta mbrojtur nga djegia.

e) Dozimi i përberesave të asfaltobetonit duhet të bëhet më saktësi 1.5% në peshë për pluhurin mineral dhe bitumin me saktësi 3% në peshë për materilet mbushësa të çfarëdo lloj madhësie.

f) Temperatura e masës së asfaltobetonit mbas shkarkimit nga përzierësi duhet të jetë në kufijtë 140 °C deri 160°C. Kur temperatura e mjedisit të jashtëm është 5 deri 10°C, kufiri më i ulët i asfaltobetonit do të jetë jo më pak se 150°C.

- Materialet e kërkua të duhet të janë në përputhje me specifikimet teknike dhe të përbushin objektin e kontratës, cdo material do të vlersohet dhe miratohet para marrjes në dorëzim nga komisioni i ngritur me urdhër të titullarit.
- Punimet do të kryhen nga Agjensia e Shërbimeve publike.
- Të gjitha materialet do të merren në dorëzim në prani të komisionit të ngritur me urdher të titullarit.
- Materialet do të transportohen sipas përcaktiveve, kërkesave dhe sasive të autoritetit kontraktor.

Punimet do të mbikqyren nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të territorit, Sektori i Shërbimeve.

Argumentim: Në bazë, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, per te garanuar permbushjen me sukses te nevojes se AK-se qe kontrata do te realizohet sipas kerkesavejane kerkuar specifikimet e mesiperme.

Specifikimet teknike u hartuan nga **Drejtoria e planifikimit dhe zhvillimit të territorit** nga znj. Ermenita Mici duke marr në konsideratë nevojat e Autoritetit Kontraktor, në përputhje me përcaktimet e nenit 36 “Specifikimet teknike” të Ligjit Nr. 162, date 23.12.2020 ‘Për prokurimin publik”, i ndryshuar e nenit 40 pikë 2, si edhe te Nenit 44 “Kërkuesat e cilësisë” të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

Gjithashtu materialet sikundër vërehet kanë specifikimet e tyre cilësore dhe sasiore sipas zërave të secilit në preventive dhe në specifikimet teknike.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tillë duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Shënim:

Referuar udhezimeve te APP, per zerat ne DST qe mund te jetë paraqitur marke/brand, operatoret ekonomik mund te ofertojne ekuivalente te tyre gjate pergatitjes se ofertes ekonomike. Në përfundim, Njësia e Prokurimit vendosi unanimisht miratimin e dokumenteve të tenderit dhe si afat përfundimtar për dorëzimin e ofertave përcaktoi datën 02.12.2024, ora 11:00.

Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit me objekt **“Blerje asfaltobeton për shtrim rrugësh me afat 3 vjeçar për vitet 2024, 2025, 2026”**.

Bashkëlidhur këtij procesverbali: Dokumentat e tenderit.

NJESIA E PROKURIMIT